

|                                                                                                                                             |                               |                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| <br>Tel: 2362566<br>Fax: 2364608<br>E-Mail: info@dpa.gov.al | <b>Policy on impartiality</b> | Code DA-PO-017                |
|                                                                                                                                             |                               | Revieë Nr 0<br>Dt: 20.05.2019 |
|                                                                                                                                             |                               | Page 1 from 1                 |

## Policy on impartiality

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është organi i vetëm akreditues kombëtar në Shqipëri, i emëruar nga Parlamenti Shqiptar përmes ligjit nr. 116/2014 "Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas Rregullores (EC) Nr 765/2008. DPA operon në përputhje me ISO / IEC 17011 dhe Rregulloren 765/2008 dhe siguron akreditimin kundrejt standardeve ndërkombëtare të harmonizuara.

DPA është e angazhuar dhe përgjegjëse për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të akreditimit në mënyrë të paanshme dhe objektive. DPA është strukturuar në mënyrë të tillë për të mbrojtur paanshmërinë. Akreditimi është një aktivitet publik dhe DPA nuk angazhohet në ndonjë aktivitet që mund të dëmtojë paanshmërinë e tij në kryerjen e funksioneve të akreditimit.

DPA nuk ka asnjë interes pronësie, tregtar apo interes tjetër në ndonjë organ të vlerësimit të konformitetit dhe siguron akreditimin në baza jo-fitimprurëse. DPA nuk kryen ndonjë aktivitet të vlerësimit të konformitetit i cili mund të jetë subjekt i akreditimit. DPA administron të gjitha skemat e akreditimit në mënyrë jodiskriminuese dhe ato i ofrohen të gjithë aplikantëve që plotësojnë kriteret për akreditim.

DPA nuk ofron shërbime konsulence. DPA kryen trajnime vetëm me qëllim të dhënies së informacionit të përgjithshëm dhe që është në dispozicion në edhe faqen zyrtare të saj. Qëllimi i trajnimeve për vlerësuesit / ekspertët e DPA është të harmonizojë proceset e vlerësimit dhe t'i bëjë ato efektive.

I gjithë personeli i përfshirë ose që mund të ndikojë në procesin e akreditimit (personeli, vlerësuesit / ekspertët, vendimmarrësit, anëtarët e Bordit të Akreditimit, anëtarët e komiteteve teknike) kërkohet të jenë të lirë nga presionet e panevojshme duke përfshirë presione tregtare ose financiare që mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të vepruar në mënyrë të paanshme dhe objektive. I gjithë personeli kërkohet të deklarojë çdo konflikt të mundshëm interesi sa herë që ai lind.

Bordi i Akreditimit i DPA dhe komitetet teknike që përfshijnë palët e interesuara ofrojnë mundësi për të kontribuar në ruajtjen e paanshmërisë.



Tel: 2362566  
Fax: 2364608  
E-Mail: info@dpa.gov.al

## Policy on impartiality

Code DA-PO-017

Revizë Nr 0  
Dt: 20.05.2019

Page 2 from 1

Për ruajtjen e paanshmërisë DPA:

- ka zbatuar një proces të veçantë për vendimmarrjen për organet e lidhura të vlerësimit të konformitetit.
- vlerëson kërcënimet e mundshme për paanshmërinë në rast dyshimi, ose së paku një herë në vit përmes auditimit të brendshëm dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut. Rezultati i vlerësimit diskutohet në Bordin e Akreditimit.

Tirana on 20.05.2019

Armond HALEBI

General Director